

Gjykata Supreme e Kosovës
PKL.-Kzz. Nr. 23/2009
11 Dhjetor 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i Kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Guy van Craen dhe Gerrit-Marc Sprenger dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Fejzullah Hasani dhe Miftar Jasiqi si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Murlan Prizreni si procesmbajtës,

në lëndën penale kundër të pandehurit Valon Miftari, emri i babait _____, emri i vajzërisë së nënës _____ e lindur me 27 mars 1980 në fshatin _____), shqiptar i Kosovës, i pamartuar, din shkrim dhe lexim, ish polic i Shërbimit Policor të Kosovës me _____ të gjendjes së mesme ekonomike dhe nuk ka qenë i dënuar më herët,

i mbajtur në paraburgim prej 8 nëntorit 2003 deri më 24 nëntor 2003 dhe që nga 12 qershori 2006,

i akuzuar me dy (2) vepra penale në kundërshtim me nenin 30 Paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Autonome të Kosovës (LPK-së), ekuivalent me Vrasjen e rëndë në kundërshtim me nenin 147 Paragrafi 11 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së, tani Kodi Penal i Kosovës, KPK-së),

duke vendosur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 11 nëntor 2008 dhe e parashtruar prej avokatit mbrojtës Fazli Balaj në emër të të pandehurit me 13 nëntor 2008, kundër aktgjykimit Nr. 389/2004, i lëshuar prej Gjykatës së Qarkut në Pejë me 12 qershor 2006, dhe të aktgjykimit nr. 583/2206, i lëshuar prej Gjykatës Supreme të Kosovës me 5 gusht 2008,

në seancën e mbajtur me 11 dhjetor 2009, pas shqyrtimit dhe votimit bie këtë

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë aprovohet (pranohet). Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë i datës 12 qershor 2006, dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i

datës gusht 2008, janë anuluar. Kjo lëndë i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Arsyetimi:

I. Historia procedurale

Me 8 nëntor 2003, në ose përafërsisht ora 17:00 në fshatin viktimat S dhe Z janë qëlluar për vdekje. I pandehuri, në kohën e incidentit zyrtar i SHPK-së jashtë orarit të punës, ishte arrestuar ditën e njëjtë. Ai menjëherë pohoi se ka qenë i sulmuar prej viktimave dhe ka shtënë për shkak të frikës për jetën e tij.

Me aktakuzën e datës 22 tetor 2004, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë e akuzoi të pandehurin me Vrasje të menjëhershme (vrasje e provokuar) në kundërshtim me nenin 33 të LPK-së dhe në mënyrë alternative me Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor në shkelje të nenit 148 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së). Aktpadia ishte konfirmuar me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 22 nëntor 2004.

Shqyrtimi kryesorë para kolegjit të përbërë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/64 (siç ndryshohet) prej dy (2) gjyqtarëve ndërkombëtar dhe një (1) gjyqtari lokal është mbajtur në mes të 12 prill 2006 dhe 12 qershor 2006. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor Prokuroria me 11 maj 2006 parashtrori aktakuzën e ndryshuar, duke e akuzuar të pandehurin me disa Vrasje në kundërshtim me nenin 30 Paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPK-së. Me 12 qershor 2006, kolegji e shpalli të pandehurin fajtor për dy (2) veprave penale të Vrasjes (privim i qëllimshëm nga jeta i viktimave S dhe Z, në kundërshtim me nenin 30 Paragrafi 1, 2 dhe 3 të LPK-së, dhe sjelli dënime të veçanta prej trembëdhjetë (13) vjetëve burgim për secilin rast të Vrasjes së tij, duke rezultuar në dënim total prej pesëmbëdhjetë (15) viteve burgim. Pohimi i të pandehurit që viktimat së pari e kanë sulmuar gojarisht e më pastaj edhe fizikisht atë dhe në fund ai ka vlarë ata për shkak të frikës për jetën e tij, është hedhur poshtë prej gjykatës së shkallës së parë.

Me 22 nëntor 2006, Avokati Mbrojtës Fazli Balaj në emër të të pandehurit paraqiti ankesë kundër aktgjyimit mbi bazat e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal në dëm të të pandehurit dhe në respekt të vendimit mbi sanksionet penale. Avokati mbrojtës Zeqir Berdyna në emër të të pandehurit paraqiti ankesë me datën 29 nëntor 2006 kundër Aktgjyimit mbi bazat e ngjashme.

Prokuroria Publike me mendimin e datës 14 nëntor 2007, diskutoi shkeljet e mundshme të ligjit penal në dëm të të akuzuarit dhe pretendoi se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të përcaktoj dënimin drejtësisht.

Në veçanti Prokuroria mendon që gjykata e shkallës së parë do të duhet të sjell vendim të veçantë për të pandehurin në vend të dënimit total të përbërë prej dy (2) dënimeve të ndara. Gjithashtu, Prokuroria ka paraqitur se do të duhej të aplikohet ligji më i favorshëm

8 i KPPK-së dhe se pohimi se i pandehuri ka vepruar në vetëmbrojtje të nevojshme nuk do të duhej të përjashtohet.

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë prej tre (3) gjyqtarëve ndërkombëtar i ka aprovuar ankesat. Me aktgjykimin e datës 5 gusht 2008, i pandehuri është shpallur fajtor për dy (2) vrasje për të cilat atij i është dhënë dënim i veçantë prej pesëmbëdhjetë (15) viteve burgim. Pjesa tjetër e ankesave është refuzuar si e pabazë dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë.

Aktvendimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar Avokatit Mbrojtës Fazli Balaj me 4 shtator 2008¹.

Me 13 nëntor 2008 Avokati Mbrojtës Fazli Balaj në emër të të pandehurit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të datës 11 nëntor 2008, kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës.

II. Çështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Avokat mbrojtës Fazli Balaj propozon të silltet aktgjykim për anulimin e aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të Gjykatës Supreme dhe ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Ai pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të kodit penal.

Në detaje avokati mbrojtës Fazli Balaj argumenton:

1. Shkeljet e dispozitave të procedurës penale:

- a. Aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme janë në shkelje esenciale e nenit 403 Paragrafit 1 dhe nenit 391 Paragrafi 1 të KPPK-së, sepse aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban asnjë dispozitiv dhe është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten. Vetë arsyetimi dështon të jap arsye lidhur me faktet përfundimtare dhe është plotësisht i paqartë dhe kontradiktor. Veç kësaj dispozitat e dy (2) ligjeve të ndryshme – Ligji mbi Procedurat Penale (LPP-ja) dhe KPPK-ja

¹ Kjo mund të vërtetohet edhe pse sipas fletëdërgesës në atë ditë "Aktvendimi" i datës 5 gusht, ishte dërguar. Me 5 gusht 2008, megjithëate, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi vetëm Aktgjykimin e lëndës në fjalë, e jo Aktvendimin.

– janë aplikuar e që është e ndaluar sepse procedura penale është unike.

- b. Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nuk paraqet faktet dhe rrethanat që e përbëjnë natyrën e veprës penale, d.m.th: nuk përmban përshkrimin faktik të këtyre veprave, domethënë motivi pas kryerjes apo rrjedha e ngjarjes.
- c. Aktakuza e ndryshuar nuk do të duhej të pranohej pasi që situata faktike nuk ka ndryshuar.
- d. Gjykata e shkallës së parë e injoroi faktin që i pandehuri ishte nën kërcënim serioz gjatë kohës para se të ndodhte krimi, dhe ishte i shoqëruar prej policisë tek vendi i punës së tij dhe mbrapa në shtëpi. Në kontekst, Gjykata e shkallës së parë gjithashtu dështoi që ta marr në konsideratë që në kohën e krimit brenda periudhës kohorë prej tre muajve e gjysmë tre policë ishin zënë në pritë dhe vrapë në
- e. Gjykata e shkallës së parë në vetëmbrojtjen e nevojshme e të mohuar në mënyrë të gabueshme i referohet obligimit të të pandehurit për të ikur prej sulmuesve dhe në atë mënyrë të arratiset.
- f. Prej rrethanave dhe fakteve të vërtetuara është e qartë se grindja ishte iniciuar prej viktimave.
- g. Në të dy Aktgjykimet, elementet subjektive të veprimeve penale nuk janë shpjeguar dhe asnjë arsyetim i qartë nuk është dhënë për të shpjeguar llojin e qëllimit me të cilën gjoja se i pandehuri ka vepruar. Distanca e shkurtë në mes të të pandehurit dhe viktimave kur të shtënat janë shtir nuk mund të shihen si dëshmi për së paku qëllimin eventual për vrasjen e viktimave. Më tepër dëshmon situatën e vetëmbrojtjes së nevojshme.
- h. Gjykata e apelit, duke e vlerësuar gabimisht faktin se i pandehuri ishte lënduar lehtë gjatë grindjes, arriti te përfundimi i gabueshëm që jeta e të pandehurit kurrë nuk ishte në rrezik.
- i. Dy gjykatat i bazuan të gjeturat e tyre në deklaratën e dëshmitarit B edhe pse ai gjoja se është anëtar i grupit të krimit të organizuar dhe edhe pse ai i ulur në veturë e cila në errëti të plotë kaloi pranë vend ngjarjes me shpejtësi prej 100 km/orë gjë që e ka bërë të pamundshme për atë që të ketë gjendjen e hollësishme të ngjarjeve.
- j. Aktgjykimi i shkallës së dytë e përshkroi deklaratën e dëshmitarit B që “përputhet me dëshmitë tjera në dispozicion”, edhe pse deklarata e tij nuk përputhet me deklaratat e dëshmitarëve të cilët ishin me të në të njëjtën veturë.

2. Shkeljet e kodit penal

- a. E gjetura e gjykatë së shkallës së parë që “kush fillon grindjen nuk mund të konstatohet” është e dykuptimshme dhe e pasaktë, sepse është e qartë prej historisë së lëndës dhe lëndimeve trupore të pandehurit që i pranoi se sulmi ka filluar prej viktimave të ndjerë.
- b. Konkluzioni i të dy gjykatave që jeta e të pandehurit nuk ka qenë në rrezik, e as që është supozuar se viktimat e kanë filluar grindjen, është shumë relative, e përgjithshme dhe si pasojë e dykuptimtë.
- c. Konkluzioni i gjykatë së shkallës së dytë që “nuk është besuar në mënyrë të arsyeshme që i ndjeri S ishte duke vepruar në mënyrë ilegale” është i gabueshëm.
- d. Konkluzioni i gjykatës së shkallës së dytë që i pandehuri do të mund të ishte nuk mund të pranohet duke marr parasysh nenin 8 Paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së.

Zyra e Prokurorit Shtetëror të Kosovës (ZPSK-ja) me mendimin, e datës 19 maj 2009, dorëzon se së paku për vrasjen e të ndjerit S aplikimi i saktë i ligjit nga pikëpamja e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet ta sjell Gjykatën Supreme të besoj që ekziston një dyshim i arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së vetëmbrojtjes dhe eventualisht në vetëmbrojtje të tepërt.

Kjo parashtresë bazohet në mendimin që i pandehuri duke i vendosur një varg të fakteve që në mënyrë legale do të arrinin në vetëmbrojtje, nuk kishte që të dëshmonte, në tërësi, se ai ishte duke vepruar në vetëmbrojtje. Do të duhej Prokurori të dëshmonte përtej dyshimit të arsyeshëm mungesën e vetëmbrojtjes për shkak të faktit se situata faktike nuk ka qenë e qartë. Ky interpretim do të ishte më tepër në linjë me parimin *favor rei* dhe me çka është e përvijuar në drejtën e Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (GJEDN).

Sa për vrasjen e të ndjerit Z, ZPSK-ja mendon se aplikimi i standardit të sipërpërmendur nuk do të mjaftoj të mbroj të pandehurin prej përgjegjësisë së tij penale. Sipas fakteve të vërtetuara sulmi aktual i të ndjerit Z undër të pandehurit nuk ka ekzistuar. Vetëm një përcaktim tjetër i situatës faktike mundet eventualisht të ketë rezultat të tillë.

Për këto arsye ZPSK-ja dorëzon propozim për gjetjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë pjesërisht të bazuar dhe

- a. Sipas nenit 457 Paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), të ndryshoj vendimin e formës së prerë në pjesën e lidhur me vrasjen e S. të aprovoj supozimin e gjendjes së vetëmbrojtjes, konstatoj ekzistimin e vetëmbrojtjes së tepruar, dhe si pasojë të aplikoj nenin 9 Paragrafi 3 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ-së);
- b. Sipas nenit 456 të KPPK-së , të refuzoj kërkesat tjera të dorëzuar prej avokatit mbrojtës Fazli Balaj.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme.

Ligji i aplikueshëm në lëndën në fjalë është Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Sipas nenit 550 të KPPK-së procedurat penale të instancës së parë, në të cilat aktakuza është parashtruar para datës së hyrjes në fuqi të KPPK (ish: Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, (KPPPK) por i cili nuk është kompletuar deri me këtë datë, do të vazhdohet në bazë të dispozitave të ligjit të aplikueshëm më herët deri sa të përfundojnë plotësisht procedurat penale me Aktvendim apo deri sa Aktvendimi i sjell në shqyrtim kryesorë të marr formën e prerë.

Aktakuza kundër të akuzuarit ishte paraqitur me 22 tetor 2004 dhe kështu që pasi që KPPPK-ja hyri në fuqi me 6 prill 2004.

Sipas nenit 452 Paragrafi 3 i PKKP-së kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të parashtrohet brenda tre muajve të dorëzimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të i pandehuri.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është dorëzuar te Avokati Mbrojtës Fazli Balaj me 4 shtator 2008. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte paraqitur me 13 nëntor 2008 dhe kështu brenda periudhës prej tre muajve.

2.

Kërkesa gjithashtu është e bazuar. Të dy Aktgjykimet janë bazuar në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penal në pajtim me nenin 451 Paragrafi 1 pika 2 në lidhje me nenin 403 Paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së, dhe të shkeljeve të ligjit penal në pajtim me nenin 451 Paragrafi 1 pika 1 në lidhje me nenin 404 Paragrafi 2 të KPPK-së.

a. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë

Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se Aktgjykimi i shkallës së parë është i bazuar në shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale në pajtim me nenin 451 Paragrafi 1 pika 2 në pajtim me nenin 403 Paragrafi 1 pika 12 të KPPK-së, dhe të shkeljeve të ligjit penal në pajtim me nenin 451 Paragrafi 1 pika 1 në lidhje me nenin 404 Paragrafi 2 të KPPK-së.

aa.

Në refuzimin e kërkesës së të pandehurit, se ai ka vepruar në vetëmbrojtje të nevojshme, Aktgjykimi përbën shkelje të parimit *in dubio pro reo* duke e lëvizur barrën e provave tek i pandehuri. Kjo është shkelje e një prej të drejtave më themelore të të pandehurit, supozim i pafajësisë, siç përcaktohet në nenin 6 Paragrafi 2 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe e pranuar në legjislacionin e vendit në nenin 3 Paragrafi 1 i – i aplikueshëm në kohën e shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë – KPPPK-së.

Nuk është i diskutueshme që i pandehuri ka shtënë në viktime dhe i ka vrarë ata. Megjithatë, dëshmitari në deklaratën e tij, siç është referuar në Aktgjykimin e shkallës së parë, i ka shpjeguar ngjarjet si në vijim:

“Kur dilnin prej shitores, dy njerëzit, që ai i njohu si S dhe Z ju afruan atij. Ata iu kërcënuan atij, gojarisht, duke bërë thirrje: ‘Ne të besonim ty dhe ti na tradhtove’. Pastaj dy njerëzit e sulmuan të akuzuarin duke e goditur atë me grushte dhe krahë, duke e shtyre, duke e kapur dhe duke e mbajtur.

.....

Marrëdhëniet ende të mira në mes të S dhe të akuzuarit (janë) u prishën pas vrasjes së zyrtarit të SHPK-së H me 6 shtator 2003. Gjatë hetimeve policore, të cilat kurrë nuk shpënjohen në identifikimin e të dyshuarit, i akuzuari i zbuloi hetuesve disa informata për S dhe shokët e tij. Në këtë kontekst ai nxjerrti shqetësim lidhur me jetën dhe sigurinë e tij, duke u frikësuar prej hakmarrjes prej S dhe

shokëve të tij. Afër një muaj para 8 nëntorit 2003 i akuzuari ka raportuar se është duke u përcjell dhe vëzhguar. Prandaj, policia e UNMIK-ut i siguroi atij përcjellje në shtëpi. I akuzuari pastaj pohohet se ishte përcjellë dy apo tri ditë para incidentit të përshkruar.

Siç deklaroi i akuzuari, fillimi i përlëshjes, që pasoi sulmin gojor, S duke bërëtitur e urdhëroi Z Z eja më ndihmo, merrja armën, ashtu që ne mund ta vrasim atë'. S pastaj e sulmoi atë nga prapa, duke e goditur (shtrenguar) atë në qafë dhe në kokë. Në vazhdim S kapi armën e të akuzuarit. Përderisa S dhe Valoni ishin duke luftuar për armë, në një moment S arriti ta marr armën. Ai e drejtoi kah barku i Valonit duke e tërhequr këmbëzën. Megjithatë, pasi asnjë plumb nuk ishte në fole, asnjë fishek nuk ishte shkrepur. Pastaj, i akuzuari arriti ta çarmatoste S ...

Sipas të akuzuarit, kur S dhe Z ishin duke e sulmuar atë, ai ra në tokë mbi gjunjët e tij duke u përkulur që të mbroj armën e tij që të mos rrëmbehet. Ai vendosi plumbin në armë duke iu kërcënuar atyre: 'Unë jam polic dhe unë do të qëlloj në ju'.

...

I akuzuari, duke mos pritur që dy sulmuesit e tij do të ndalnin grindjen, i frikësuar për jetën e tij, në të njëjtën kohë duke pranuar se S dhe Z qartë ishin të paarmatosur, kurrë nuk iu ishin referuar posedimit të çfarëdo arme.

I akuzuari ka shtënë me armën e tij dy herë mbi supin e tij, duke e drejtuar armën në ajër. Z i cili ishte mbi Valonin, ishte i goditur (plagosur) prej plumbave në fytyrën e tij dhe në dorën e majtë. I akuzuari deklaroi se në atë kohë ai nuk ishte i vetëdijshëm se e ka vranë Z

I akuzuari mbajti në mend se, menjëherë pasi që e ka qëlluar Z dy herë, S ishte duke e prekur dorën e tij dhe duke e tërhequr parakrahun e tij, duke tentuar që ta rrëmbej atë me dorë. Valoni frikësohej për jetën e tij, sepse S, gjatë gjithë sulmit e mbajti dorën në apo afër brezit (ripit) në atë mënyrë që i akuzuari besoi se ai ka armë. Ai pohoi se ai 'dyshoi 100% se ai kishte armë'. I akuzuari pranoi se ai pastaj shtiu të shtënë e tretë brenda një sekonde prej dy të shtënave tjera. Arsyet e dhëna prej të akuzuarit para gjyqtarit hetues ishin që: 'Unë isha duke e pritur atë (S) që të shtijë në mua ... Unë mendova se ai do të më qëllonte mua', 'Unë kisha ndërmend të qëlloj në trupin e tij sepse kjo ishte përpjekja ime e fundit për të ia mbathur' I akuzuari pohoi para gjyqtarit hetues që, pasi që qëlloi për

herë të tretë, ai e humbi shikimin dhe 'iu errësua' dhe që atij i kujtohet vetëm turbullt shtirja e katërt (shtirja e dytë në S).

Pasi që ai ndaloi të qëlluarit, i akuzuari u largua prej vendngjarjes në drejtim të shtëpisë së tij, dhe e thirri Stacionin Policor në aë radion e tij portative.”

Është e rëndësishme që deklarata e të pandehurit pjesërisht është vërtetuar prej dëshmimeve tjera të referuara në Aktgjykimin e shkallës së parë. Nuk ka kurrfarë dyshimi që përleshja ishte në zhvillim e sipër në mes të pandehurit dhe dy viktimave dhe lëndimet i ishin shkaktuar të pandehurit, i cili mori gërvishtje dhe prerje të vogla dhe shenja të kuqe në qafën e tij, në shpinë, supë dhe në të dy gjunjët.

Gjithashtu sjellja e të pandehurit pas të shtënave, siç përshkruhej prej dëshmitarëve të tjerë, vërteton deklaratën e tij.

I pandehuri është parë prej dëshmitarëve F dhe Y luke ikur pas të shtënave derisa ulërinte – sipas dëshmitarit Y – apo madje duke ulëritur “Unë vrava dy njerëz” – sipas dëshmitarit F

Gjithashtu, dëshmitari R e pa të akuzuarin menjëherë pas ngjarjes duke thënë “Oh zoti im. Ata më kanë rrahur. Unë nuk e di nëse i kam vrarë ata”. Në veçanti, deklarata e këtij dëshmitari është, çka gjykata e shkallës së parë dështoi të marr në konsideratë, e që ishte e një rëndësie të veçantë, sepse dëshmia e tij i referohet llogaridhënies së parë dhe spontane të dëshmitarit në lidhje me veprat e tij, pa pasur kohë të konsideroj mbrojtjen, i lënë vetëm para këshillës juridike. Kjo gjithashtu është fakt se i pandehuri vetë e thirri policinë pasi që arriti në shtëpi e kjo nuk mund të injorohet si tregues i shqetësimit të rëndë mental të të pandehurit i cili vërteton përshkrimin e tij të ngjarjeve.

Prej Aktgjykimit dëshmi të mëtutjeshme që vërtetojnë deklaratën e të pandehurit mund të shihen në historinë e lëndës.

Bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve Sk Ha , X , M dhe Sa , gjykata e shkallës së parë konstatoi se fillimisht marrëdhënia e mirë në mes të të pandehurit dhe viktimave është prishur pasi që një prej kolegëve të të pandehurit është vrarë dy muaj më parë dhe pastaj i pandehuri i ka dhënë policisë disa informata lidhur me Sadik Zenelin.

Njohuria bazë e zakoneve lokale (vendore) është e mjaftueshme për të kuptuar që kjo e ka vënë të pandehurin në një rrezik të lartë të shihet si tradhtar, aq më tepër nëse është e vërtetë që gjatë konfliktit të armatosur në periudhën 1998/1999 ka gjetur strehim në shtëpinë e S për disa javë. Kjo e vërteton deklaratën e të pandehurit së paku deri tani pasi që kallëzimi i tij i sulmit kundër tij nuk mund të largohet si pamundur.

Si përfundim, edhe në Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë – e cila në lidhje me këtë, siç do të shpjegohet më vonë, nuk mund të shihet si model i gjallë (papërvojë) i kompletimit – ca dëshmi të varura nga rrethanat janë regjistruar duke vërtetuar deklaratën e të pandehurit. Fakti i vetëm i cili sipas Aktgjykimit të shkallës së parë nuk mund të vërtetohet është pyetja se kush e filloi grindjen.

Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë ia caktoi barrën e provave të pandehurit. Pjesa relevante e Aktgjykimit thotë si në vijim:

“Kolegji megjithatë në interes të të akuzuarit nuk mundet as ti marr kërkesat nga ligji për vetëmbrojtjen e nevojshme e as Nevojën Ekstreme apo Vrasjen e Provokuar siç është e definuar në

Në këtë mënyrë, Gjykata duke i marr faktet nuk mundi ti jap të akuzuarit përfitimin e dyshimeve lidhur me ekzistimin e fakteve relevante të lëndës siç përcaktohet në nenin 3 Paragrafi 2 të KPPK-së.”

Duke vepruar kështu, gjykata e shkallës së parë shpërfilli supozimin e pafajësisë e formuluar në nenin 3 Paragrafi 1 të LPK-së në përputhje me nenin 6 Paragrafi 2 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Sipas këtij parimi, barra e provave qëndroi (u pezullua) me ndjekjen penale (prokurorinë).

I pandehuri dorëzoi shpjegim shfajësues për ngjarjen. Në situatë të këtillë supozimi i pafajësisë kërkon që gjykata duhet të jetë e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm që kallëzimi i dhënë prej të pandehurit nuk është i vërtetë. Prandaj, barra e provave lidhur me gënjeshtren e pohimit të të pandehurit bie mbi prokurorinë. Për zhvendosjen e barrës së provave prej prokurorisë te i pandehuri, siç është bërë nga gjykata e shkallës së parë, ka krijuar obligim për të pandehurin që ta dëshmojë pafajësinë e tij përtej dyshimit të arsyeshëm, kështu duke shkelur një prej të drejtave më esenciale të procedurës e përfshirë në nenin 6 Paragrafi i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

bb.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë shkeli dispozitat e ligjit penal në mohimin e pohimit të të pandehurit të vetëmbrojtjes së nevojshme duke nxjerr si përfundim se jeta e të pandehurit kurrë nuk ishte në rrezik, edhe nëse viktimat e ndjera kishin filluar grindjen. Kjo e ngatërron parakushtin e vetëmbrojtjes së nevojshme e cila sipas ligjit përcaktohet në nenin 8 Paragrafi 2 të LPK-së (identike me atë të aplikuar në shqyrtimin kryesorë KPPK) si:

“veprim të shmang sulmin e paligjshëm, të vërtetë dhe të shpejtë (pashmangshëm)”.

Ligji nuk kërkon që sulmi duhet të jetë kërcënues për jetën. Serioziteti i sulmit është vetëm në interes në kontekstin me pyetjen nëse vepra e kryer në mbrojtje është proporcionale me shkallën e rrezikut e paraqitur nga sulmi. Kështu që, gjykata e shkallës së parë e ngriti pragun për sulm shumë lart dhe duke e bërë këtë e shkeli nenin 8 të LPK-së.

cc.

Gjykata e shkallës së parë me referencë kryesisht në deklaratën e dëshmitarit B përjashtoi atë që i pandehuri gjatë grindjes e humbi kontrollin. Mënyra në të cilën ky vlerësim është formuluar në Aktgjykimin e shkallës së parë ngre dyshime serioze në saktësinë e përcaktimit faktik dhe kështu që duhet të adresohet nga ky kolegji i Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 458 të KPPK-së që thotë:

“Kur me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim me të cilin vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësori në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër kompetente të shkallës së parë.”

Vrojtimet e dëshmitarit B janë përshkruar në Aktgjykim siç vijon:

“Në largësi 5 deri në 10 metra prej personave që grindeshin, dhe në shpejtësi prej 60 deri në 80 km/orë që vetura kaloi pranë, përderisa B vazhdoi veprimet e palëve duke e kthyer kokën për të pasur një pamje të fiksuar nëpërmes dritares së pasme. Ai insistoi që kurrë nuk e ka humbur pamjen e veprimet, pasi që dritarja e tij ishte e hapur.

.....

Duke kaluar nga distancë e afërt e kuptoi se ishin persona duke u grindur, 4 persona në dy grupe. Ai kërkoi nga vozitësi që të ndalet. C për ta bërë këtë u dashtë të vozis në një pikë rrotulluese, tek nje xhami e vogël që ishte pak më larg, e bëri një gjysmërreth dhe u ndal afro 5 metra larg prej vendngjarjes.

.....

Derisa grindeshin, palët u larguan prej rrugicës së ngushtë tek mesi i rrugës, kështu që vetura që duhej kaluar duhej të lëvizte në anën tjetër të rrugës për t’iu shmangur atyre. Personat po grindeshin, duke grushtuar dhe shkëlmuar njëri-tjetrin. Në një moment S e

rrëmbeu Valonin dhe e përplasi për tokë, dhe kjo ishte, siç dëshmoi B momenti kur Valoni u ngrit, e morri armën e tij prej anës së trupit të tij dhe qëlloi në S. Personat që grindeshin derisa qëllonin lëviznin afër njëri-tjetrit, ende nuk ishin koklavitur.

.....

B më tutje dëshmoi se kur S ishte qëlluar nga të shtënat, grupi i dytë e ndali grindjen. Z filloi të bërtas 'ti ma ke vrarë ... (gjyshin tim, dajën/axhën tim apo diçka të tillë)', dhe qëndroi si i ngrirë. Valoni shtiu në të dhe Z ra në tokë. Personi i gjykatës e rrëmbeu Valonin, duke thënë 'të ikim' dhe u largua prej vendngjarjes në drejtim të shtëpisë së Valonit; pastaj Valoni filloi ti bërtiste vëllait të tij, i cili ishte në shitore: 'Unë vrava dy persona'. ...

B insistoi se e ka parë Valonin duke e futur plumbin e parë në folenë e armës së tij sepse ai ishte afër vendngjarjes.

.....

Ai e pa të akuzuarin duke rërë në gjunjët e tij me S mbi të, e pastaj e vëzhgoi atë duke u ngritur dhe duke përdorur armën e tij.

Revolja Glock 9 mm nuk shkrep pa e rimbushur dhe pa e tërhequr siguresën, siç u përshkrua nga B

B deklaroi se në një moment gjatë grindjes, i akuzuari e tërhoqi armën e cila përpara gjatë grindjes nuk ishte e dukshme."

Gjykata e shkallës së parë e klasifikoi këtë dëshmi në mënyrë të saktë me shumë hollësira për fazat e ndryshme të grindjes.

Megjithatë, gjykata e shkallës së parë kurrë nuk e ka vlerësuar apo diskutuar besueshmërinë e këtij dëshmitari, pavarësisht pikëpyetjeve të dukshme lidhur me dëshminë e tij. Prej katër personave që ishin udhëtar në veturë, ai ishte i vetmi i cili e dha deklaratën në detaje të tilla. Kjo do të duhet të kërkonte vlerësim dhe diskutim të thellë se pse posaçërisht ky dëshmitar ishte në gjendje të vëzhgoj ngjarjet aq për së afërmi. Ky vlerësim do të mund të sillte menjëherë pyetjen nëse rrethanat e lëndës e lejuan dëshmitarin B të vëzhgoj ngjarjen në detaje të tilla.

Sipas Aktgjykimit

"ka qenë errët, drita e vetme ishte drita që shpërndahej prej shitoreve pranë dhe të dritave të përparme të veturës".

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar largësinë në mes të këtyre shitoreve dhe të lagjes me qëllim që të ketë një tablo precize të dukshmërisë. Megjithatë, prej vetë Aktgjykimit rezulton se dukshmëria ishte në cilindo rast shumë e dobët. Në këtë gjendje

dëshmitari B i bëri vëzhgimet e tij si udhëtar në veturë e cila sipas Aktgjykimit kaloi pranë vendngjarjes me shpejtësi 60 deri 80 km/orë, vazhdoi deri sa vozitësi gjeti një vend për tu kthyer dhe u kthye në vendngjarje ku u ndal.

Kundër prapavijës së dukshmërisë së dobët, pyetje vendimtare është nëse dëshmitari B vërejti këto ngjarje të cilat ndodhën para të shtënave prej veturës që kaloi pranë apo prej veturës pasi që u kthye dhe që u ndal. Kjo pyetje në mënyrë precize është përgjigjur nga Aktgjykimi i shkallës së parë, i cili thotë si në vijim:

“Kolegji ndoqi së pari dëshminë e dëshmitarit kyç okularë B

Besueshmëria e tij është përtej çfarëdo dyshimi. Ai nuk e kishte gabim kur ai i tha vozitësit të kthehet mbrapa në vendngjarje të incidentit sepse ai pa të shtënat dhe dy njerëz duke rënë.” (nuk është nënvizuar në origjinal).

Kjo nuk lënë asnjë dyshim që ngjarjet vendimtare ndodhën para se vetura të kthehet dhe të vi tek vendngjarja. Kështu që është e qartë që dëshmitari B duhet ti ketë bërë vërtetimet e tij derisa vetura ishte duke u afruar, duke kaluar pranë dhe duke u larguar prej vendngjarjes me një shpejtësi prej së paku 60 deri në 80 km/orë.

Në këtë kontekst nuk mund të injorohet që gjykata e shkallës së parë u mbështet thjeshtë në treguesin e shpejtësisë të dhënë prej dëshmitarit B, duke e bërë këtë pra lihet anash referimi dhe vlerësimi i deklaratave të dëshmitareve të udhëtarëve të tjerë në veturë të cilët dëshmuuan se shpejtësia ishte edhe më e lartë, deri në 110 kilometra në orë², e cila është deklaruar në veçanti nga dëshmitari C i cili ishte vozitësi i veturës.

Prej kësaj dukshmërie të dobët është e diskutueshme nëse vërtetimet e sakta prej largësisë prej më tepër se 30 deri 50 metra ishin fizikisht të mundshme, në veçanti pasi që vetura kaloi pranë dhe aty nuk kishte ndriçim më prej dritave të përparme të veturës. Kështu që dëshmitari B ië cilindo rast kishte vetëm disa sekonda për vërtetimet e tij që e bënë atë tepër të dyshimtë që ai ka qenë në gjendje të vëzhgojë të gjitha hollësitë e përshkuara prej tij. Kjo adresohet më tepër në kujtesën e tij të gjoja shkëmbimit të fjalëve në mes të viktimave dhe të pandehurit gjatë grindjes.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, siç është treguar më lart del prej Aktgjykimit që tre dëshmitarët tjerë të cilit ishin të ulur në veturë vërejtën shumë më pak hollësitë të ngjarjes.

Dëshmitari C është referuar në Aktgjykim vetëm në lidhje me vërtetimin e tij pas të shtënave, që dy personat u larguan prej vendngjarjes.

Dëshmitari D pa tre apo katër persona duke u grindur dhe duke shtyre njëri tjetrin dhe dy persona duke u larguar prej vendngjarjes.

² Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, faqe 21 (versioni në Gjuhën Angleze)

Dëshmitari E pa vetëm tre apo katër persona duke u përleshur.

Të gjitha këto karakteristika do të duhej të kërkohej vështrim hetues i plotë i dëshmisë së dëshmitarit B i cili megjithatë nuk ishte i rëndësishëm së vogël por të madhe, sepse dëshmia e tij ishte për gjykatën e shkallës së parë pjesa kryesore e dëshmive për refuzimin e pretendimit të dëshmitarit për vetëmbrojtje.

Vlerësimi i këtyre, megjithatë, nuk mund të gjendet në Aktgjykimin e shkallës së parë. Kështu ky koleg i Gjykatës Supreme gjen se ekziston dyshim i konsiderueshëm në saktësinë e përcaktimit faktik në Aktgjykimin e shkallës së parë.

dd.

Dyshimet e mëtuqeshme lidhur me saktësinë e përcaktimit faktik duhet të adresohen sa i përket gjendjes mentale të të pandehurit derisa i vriste viktimat.

Siç u përmend më lart, në Aktgjykimin e shkallës së parë referimi mund të gjendet te disa dëshmitarë dëshmia e të cilëve mund të shihet si tregues për shqetësimin mental të të akuzuarit. Veç kësaj prej Aktgjykimit të shkallës së dytë³ del se ka pasur më tepër dëshmi në lidhje me këtë e cila nuk është marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë.

Në të vërtetë përmbledhja e të gjitha dëshmive dhe fakteve në dispozicion të cilat mund të konsiderohen kur të përcaktohet gjendja mentale e të pandehurit derisa i vriste viktimat tregon një sasi të madhe të materialit substancial.

Së pari është, në histori të lëndës, frikësimi i të pandehurit që ndjeu ndaj atij. Kolegu i të pandehurit ishte vrarë për afërsisht dy muaj më parë, dhe i pandehuri besonte që S ka qenë i përfshirë në këtë krim. I pandehuri u ndje nën kanosje të veçantë pasi që ai raportoi emrin e S në polici. Marrëdhënia në mes të familjes së tij dhe familjes së S u prish. Babai i të pandehurit publikisht ishte raportuar si bashkëpunëtor i Serbëve çka bëri që anëtarët e familjes Miftari të ekspozohen rrezikut serioz të hakmarrjes.

Kundër këtij sfondi në natën kritike i pandehuri, në kohën kur kishte vetëm njëzet e tre (23) vjet u përfshi në grindje me S dhe Z. Ai u lëndua, edhe pse vetëm lehtë, dhe është edhe e qartë që gjatë grindjes situata u zhvillua në të cilën i pandehuri ishte përplasur në tokë dhe kështu që ishte në pozitë mjaft të keqe.

Së dyti, numri i të shtënave prej të pandehurit mundet gjithashtu të shihet si shenjë e shqetësimit mendor në situatën konkrete. I pandehuri shtiu jo më pak se shtatë (7) të shtëna në viktimat.

E treta, përshkrimi i ngjarjeve prej vetë të pandehurit, siç është referuar në Aktgjykimin e shkallës së parë, tregon humbje të pjesshme të kujtesës që mund të jetë pasojë e shqetësimit ekstrem. Në këtë kontekst duhet të theksohet që i pandehuri nuk i ka

³ Shih numrin 4.3.1.6. të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme

shfrytëzuar këto humbje të kujtesës, sikurse në rastet tjera, me qëllim që ta arsyetojë vetveten gjë e cila mund ta rrisë besueshmërinë e tij.

E katërta, pajtueshmëria e të akuzuarit⁴ pas ngjarjeve tregon disa veçori të cilat duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të gjendjes së tij mendore. Të gjithë dëshmitarët që panë apo dëgjuan të pandehurin pas sulmit, e përshkruan atë njëzëri se kishte një sjellje të çuditshme.

Dëshmitari Y e pa të pandehurin duke thënë “oh ku ku⁵ e vrava axhën/dajën S. ” dhe duke ikur e duke mbajtur armën në dorë.

Dëshmitari R e pa të pandehurin menjëherë pas të shtënave duke i thënë “Ku ku, unë i vrava dy veta, ata më rrahën e unë i vrava”. I pandehuri bërtiste dhe dëshmitarit i dukej shumë i shqetësuar.

Dëshmitari M i takua me të pandehurin menjëherë pas ngjarjeve në lagje dhe ai i kishte thënë se “S dhe Z së pari e rrahën atë, deshën t’ia marrin revolen e pastaj ai i vrau ata”. Sipas deklaratës së këtij dëshmitari, i pandehuri fliste me zë të lartë, ishte i hutuar, ecte në mënyrë të çuditshme dhe shpesh thoshte “Ku ku”. Dëshmitari e përshkroi se si i pandehuri shkoi në shtëpinë e tij, por u largua pas disa minutave dhe iku nëpër përrua në drejtim të fushës së futbollit. Ai ishte përshkruar prej dëshmitarit

G si “jashtë kontrole”. Në këtë kontekst duhet të përmendet që kjo sjellje e të pandehurit nuk mund të shihet në asnjë mënyrë si përpjekje për të ikur pasi që vetë i pandehuri ishte ai që thirri policinë dhe i cili ishte në kontakt me telefon me policinë.

Dëshmitari A polici i cili pranoi thirrjen e të pandehurit, e përshkroi zërin e të pandehurit si “jo të zakonshëm, dhe ai dukej se po qante”.

Njësoj si dëshmitari I polici i cili e dëgjoi të pandehurin duke folur nëpërmes radios së tij policore, dhe përshkroi zërin e të pandehurit si “zë të thekshëm” kur tregoi përmes radios se ai kishte vrarë dikë që ka tentuar t’ia rrëmbejë armën.

Ngjashëm, dëshmitari K polic i cili dëgjoi të pandehurin duke folur në radio, dëshmoi që i pandehuri tingëllonte “goxha i shqetësuar kur ai përmendi dikë që tentoi t’ia rrëmbejë armën dhe ai e vrau”.

Polici F në deklaratën e tij përshkroi të pandehurin duke qarë tërë kohën, duke qenë bashkëpunues dhe duke dorëzuar në mënyrë vullnetare armën dhe municionin e tij. Veç kësaj, i pandehuri nuk mund të merrej në pyetje prej policisë në të njëjtën ditë. Prokurori i këshilloi hetuesit që mos ta marrin deklaratën e të pandehurit deri të nesërmen “për shkak të situatës emocionale të të dyshuarit”⁶.

⁴ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme nën 4.3.1.6.

⁵ Ku ku është shprehje shqipe për “oh zoti im”, e përdorur në kontekst kur ngjarjet kanë shkuar tmerrsisht keq

⁶ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, faqe 27 nën 4.3.2.1

Si rezultat nuk mund të injorohet që ekziston dëshmi e fortë në historinë e incidentit, të vetë incidentit dhe të pajtueshmërisë së të pandehurit pas krimit që gjendja e tij mentale ishte disi e ndikuar prej vrasjes së viktimave. Të gjithat tiparet e përshkruara janë materiale të vlefshme për vlerësimin e gjendjes së mundshme serioze mentale të zemërimit (tërbimit). Vështrimi i nevojshëm hetues i këtij materiali thërret për ekspertizë prej kolegjit të psikologëve të mjekësisë ligjore. Në përputhje me rrethanat, Prokuroria gjatë shqyrtimit të shkallës së parë ka kërkuar ekzaminimin psikologjik të të pandehurit. Gjykata e shkallës së parë e refuzoi këtë kërkesë me arsyetimin vijues:

“Gjatë gjykimit, nuk është nxjerrë asnjë fakt i cili do të mund t’i mbështeste analizat e ekspertit d.m.th. asnjë element i cili do të ishte bazë për analiza të ekspertit mbi shqetësim të mendjes apo të gjendjes psikike të të akuzuarit, para, gjatë dhe pas incidentit.”

Ky kolegji i Gjykatës Supreme në aspektin e fakteve të lartpërmendura dhe të dëshmive nuk pajtohet me këtë konkluzion dhe gjen se gjykata e shkallës së parë ishte e obliguar të pranonte propozimin e prokurorisë lidhur me ekspertizën psikologjike të të pandehurit me qëllim të vërtetimit të fakteve në mënyrë komplete dhe të saktë.

b. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 5 gusht 2008, shkel ligjin penal sipas nenit 451 Paragrafi 1 pika 1 e lidhur me nenin 404 Paragrafi 2 i KPPK-së në mënyrë të ngjashme.

aa.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adreson pyetjen e mbrojtjes së nevojshme vetëm nën titull si pjesë e sulmit. Përveç faktit që kjo çësje duket shumë më e ngushtë, Gjykata Supreme pajtohet me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut lidhur me totalin e mungesave të dëshmive deri më tani dhe nxjerr përfundim:

“Parimi *in dubio pro reo*, nuk kërkon rezultat të ndryshëm. Për dyshimet që rezultojnë në interpretim në interes të të pandehurit (Neni 3.2 KPPK-së), atje duhet të ketë dëshmi kontradiktore të vlerës së njëjtë në mes të cilës asnjë zgjedhje nuk është e mundshme. Në rast të këtillë ekziston dyshimi. Do të ekzistonte dyshimi nëse një dëshmitar e pa S duke filluar grindjen, përderisa tjetri këtë e kontestoi. Megjithatë, në situatën e tanishme askush nuk e pa fillimin e grindjes dhe nuk ekziston asnjë dëshmi në dispozicion për të vendosur në çështje. Kështu që nuk ekziston asnjë dyshim në

çështje. Është thjesht e pamundur të vendoset se kush e filloi grindjen.”

Ky kolegji i Gjykatës Supreme, me respekt të plotë, gjen se ky përfundim shpërfill supozimin e pafajësisë. Nuk ekziston rregull në ligjin vendor apo në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut që dyshimi është i mundur vetëm në rastin e dëshmive kontradiktore. Natyrisht, dyshimi lidhur me faktin mund të ngrihet prej mungesës së thjeshtë të çfarëdo dëshmie. Për të përdorur këtë mungesë totale të dëshmive kundër të pandehurit, siç është bërë në Aktgjykimin e shkallës së dytë, mundet dukshëm të shpie në pasoja absurde. Nëse nuk ekziston asnjë çfarëdo qoftë dëshmie që i dyshuari ka kryer krim, a do të thotë kjo se nuk ekziston asnjë dyshim që ai e ka kryer atë në të vërtetë dhe se është fajtor? Për nga pikëpamja ligjore kjo mundet përsëri të jetë zhvendosje e barrës së provave prej prokurorisë tek i pandehuri, i cili duhet të dëshmojë pafajin e tij dhe si pasojë shkeljen e një prej të drejtave më themelore njerëzore të cilido të dyshuar.

Kjo shkelje e ligjit është e mbështetur në një pjesë të Aktgjykimit ku Gjykata Supreme vlerëson domosdoshmërinë e vetëmbrojtjes⁷. Aktgjykimi mohon parakushtin e sulmit të “paligjshëm” të të pandehurit nga mungesa e dëshmive sa i përket pyetjes se nga kush ka filluar grindja. Përsëri duhet të jetë shqetësuese që së paku në lëndën ku vetë grindja është e pamundur, dhe ajo ka bazuar në parimin e supozimit të pafajësisë, të jetë prokuroria e cila duhet të dëshmojë që sulmi ka qenë i ligjshëm. Përndryshe, i pandehuri duhet të jetë i detyruar të dëshmojë pafajësinë e tij.

bb.

Së dyti, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkel dispozitat e ligjit penal kur e aplikon nenin 9 Paragrafin 2 të LPRSFJ-së në vend të nenit 8 të KPK-së (KPPK-së).

Neni 8 i KPK-së do të duhet të aplikohet sepse është më i favorshëm. Pasi që ngjarja ka ndodhur para hyrjes së KPPK-së në fuqi, ligji më i favorshëm duhet të aplikohet në pajtim me nenin 2 Paragraf 2 të KPPK-së (KPK-së). Neni 8 i KPK-së është më i favorshëm, sepse i referohet Paragrafit 2 të një veprimi të kryer për të shmangur sulmin e paligjshëm, të vërtetë dhe të shpejtë, përderisa neni 9 paragrafi 2 i LPRSFJ-së e kufizon të drejtën e të pandehurit në veprim i cili është *absolutisht* i nevojshëm për shmangien e sulmit të menjëhershëm dhe të paligjshëm. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në mënyrë të dukshme është faktikisht i bazuar në dispozita më të rrepta të ligjit të vjetër siç mund të shihet prej arsyeve vijuese:

“Përdorimi i armës së tij nga Valon MIFTARI nuk ishte absolutisht i nevojshëm. Valon Miftari mund të arratiset duke ikur”⁸.

Kjo është më tepër interpretim i qartë i ligjit. Kjo e drejtë për të ikur ekziston gjithmonë dhe nuk kërkon leje të veçantë ligjore. Neni 8 i KPK-së në mënyrë specifike lejon

⁷ Shih numrin 4.3.5.1. të Aktgjykimit

⁸ Shih faqe 32 të Aktgjykimit (versioni në Gjuhën Angleze)

shmangien e sulmit, që do të thotë se Mbrojtja lejohet të përfundoj sulmin me efekt të menjëhershëm. Veç kësaj, dhe vetëm për hir të kompletimit, ideja që i pandehuri mund të kishte ikur është shumë hipotetike dhe do të kërkonte një vlerësim të përgjithshëm të të gjitha rrethanave nëpërmes syve të tij në situatën konkrete.

cc.

E treta, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkeli dispozitat e ligjit penal dhe të ligjit të procedurës penale në përjashtimin e vrasjes së provokuar sipas nenit 33 të LPK-së.

Ky kolegji i Gjykatës Supreme plotësisht pajtohet me mendimin e kolegjit të mëparshëm që gjendja e nervozizmit (zemërimit) serioz i referohet gjendjes e cila është një gjendje psikike e jashtëzakonshme që në mënyrë substanciale dobëson kapacitetin e personit për të menduar dhe reaguar në mënyrë normale⁹. Ky kolegji i Gjykatës Supreme, megjithatë me plot respekt nuk pajtohet me mendimin e kolegjit të mëparshëm se mund të përjashtohet që i pandehuri ka vepruar në gjendje të tillë psikike.

Ekziston, siç u përshkrua më lart në detaje, dëshmi e mjaftueshme që tregon se i pandehuri ka vepruar në gjendje të nervozizmit (zemërimit) serioz. Shumica e kësaj dëshmie është e paraqitur në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme por e refuzuar si jo relevante, sepse i referohet gjendjes së të pandehurit *pas* vrasjeve.

Kjo bie shumë shkurtë.

Së pari, në heqjen e kësaj dëshmie si jo relevante Gjykata ka dështuar të vështroj dëshminë në tërësinë e saj duke përfshirë, për shembull, historinë e lëndës.

Së dyti, është e padiskutueshme në Psikologjinë e Mjekësisë Ligjore që karakteristikat në sjelljen e autorit të krimit në mënyrë të drejtpërdrejtë pas krimit janë fakte të vlefshme për vlerësimin e gjendjes psikike të autorit të krimit derisa janë duke e kryer krimin. Si pasojë, pyetjet nëse sjellja e treguar prej të pandehurit pas incidentit është e mjaftueshme për të tërheq konkluzione në gjendjen psikike të tij derisa i vranë viktimat dhe cilat konkluzione të mundshme mund të tërhiqen, duhet të përgjigjen prej ekspertit të psikiatrisë, e jo prej Gjykatës.

E treta, Gjykata e shkallës së dytë mendoi se ekspertiza psikiatrike nuk është e nevojshme sepse:

“caktimi i psikiatrit tri vite pas të shtënave nuk do të siguronte asnjë depërtim kuptimplotë, të rëndësishëm në lidhje me gjendjen psikike të Valon Miftarit në kohën e vrasjeve”.

⁹ Shih numrin 4.3.5.3. të Aktgjykimit

Kjo duket të jetë keqkuptim i parakushteve për vlerësimin mjekësor, sepse zakonisht gjendja e zemërimit serioz venitët dosido pas disa orëve, që do të thotë se edhe ekzaminimi i shpejtë nuk do të mund të bazohet në material më të mirë. Veç kësaj, prapë nuk është në kompetencë të Gjykatës të vendos nëse eksperti do të jetë në gjendje të vlerësojë materialin në dispozicion. Ky vendim duhet të bëhet nga eksperti..

Edhe më shqetësuese, mendimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet të vështrohet si shkelje e parimit për gjykim të drejtë siç paraqitet në nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. I pandehurit i është mohuar e drejta në ekspertizë në favorin e tij të mundshëm bazuar në kohën e shkuar për të cilën ai nuk është përgjegjës.

Në fund, mendimi i gjykatës së shkallës së dytë gjithashtu shkel parimin *in dubio pro reo*. Pasi që i pandehuri pretendon se ai ka vepruar në gjendje të zemërimit serioz dhe pasi që ekziston edhe ca dëshmi vërtetuese, gjykata nën parimin *in dubio pro reo* duhet të përjashtohet përtej dyshimit të arsyeshëm që gjendja psikike e të pandehurit ishte jashtëzakonisht e ndikuar. Çfarëdo paqartësie lidhur me këtë përjashtim duhet të interpretohet në favor të të pandehurit, e jo kundër tij.

c.

Si rezultat, ky kolegji i Gjykatës Supreme gjen se të dy Aktgjykimet përbëjnë shkelje të dispozitave të ligjit penal.

Pasaktësitë e përshkruara në përcaktimin e fakteve kërkojnë që në pajtim me nenin 458 të KPPK-së, Aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme të anulohen dhe që lënda të kthehet për gjykim të ri para Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Pasi që faktet nuk janë të qarta ende, nuk është e mundur për këtë kolegji të Gjykatës Supreme të vërtetojë kualifikimin ligjor të lëndës. Të dy viktimat janë vrarë brenda një periudhe të shkurtë kohore gjatë një ngjarjeje të turbullt që ndërlidhet me të dy vrasjet. Si pasojë, përcaktimi i saktë i fakteve mund të ketë ndikim në kualifikimin ligjorë të secilës prej vrasjeve.

Për rigjykim Gjykata Supreme e Kosovës alarmon gjykatën e shkallës së parë në pajtim me nenin 459 Paragrafi 2 i KPPK-së që është e rëndësishme shqyrtimi në veçanti i dëshmisë së dëshmitarit B në aspektin e rrethanave të veçanta siç janë përshkruar më lart. Rekonstruktimi i ngjarjeve nën aspektin e kushteve ngjashme mund të jetë i dobishëm në këtë kontekst.

Gjithashtu gjatë rigjyimit ekspertiza psikiatrike e kolegjit të ekspertëve duhet të pranohet me qëllim të vlerësimit të gjendjes psikike të të pandehurit derisa i vriste viktimat, veç nëse gjykata gjen se të pandehurin të pafajshëm për shkak të vetëmbrojtjes së nevojshme. Me qëllim të lehtësimit të përcaktimit të gjendjes së tij psikike, ekspertët duhet të pajisen me të gjitha informatat relevante bazuar në përcaktimin e plotë dhe të saktë të situatës faktike, gjykata e shkallës së parë duhet të përcaktoj kualifikimin ligjor të

veprave të kryera nga i pandehuri me respekt të plote për parimet themelore siç janë: *supozimi i pafajësisë dhe in dubio pro reo*.

Përfundimisht, për procedurën e rigjyimit, gjykata e shkallës së parë duhet të respektoj dispozitën e nenit 459 të KPPK-së, në veçanti ndalimi i parimit *reformation in peius*, siç përcaktohet në nenin 459 Paragrafi 4 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PKL.-Kzz. Nr. 23/2009

Kryetari i Kolegjit


Norbert Koster

Anëtar i kolegjit

Guy Van Craen

Anëtar i kolegjit

Fejzullah Hasani



Anëtar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtar i kolegjit

Miftar Jasiqi